



Politika e Asistencës Financiare - Përmbledhje me fjalë të thjeshta

Politika e Asistencës Financiare (Financial Assistance Policy, FAP) e "Northwell Health", është krijuar për t'u ofruar shërbime me ulje çmimi pacientëve të kualifikuar, për të gjitha apo për një pjesë të shërbimeve të urgjencës mjekësore, ose të shërbimeve të nevojshme të kujdesit shëndetësor, që spitalet e saj apo subjektet e përjashtuara nga tatimi ofrojnë (sipas përkufizimit në IRS). Pacientët që kërkojnë asistencë financiare duhet të aplikojnë për programin, i cili është përmbledhur si më poshtë.

Shërbimet e Kualifikuara - Në përgjithësi, FAP vlen për shërbimet e urgjencës mjekësore ose për shërbimet e nevojshme të kujdesit shëndetësor që ofrohen dhe faturohen nga spitalet e "Northwell Health" dhe nga subjektet e përjashtuar nga tatimi (sipas përkufizimit në IRS).

Pacientët e Kualifikuar - Në përgjithësi, pacientët që ndodhen brenda zonës së shërbimit të "Northwell Health", që marrin shërbimet e kualifikuara, të cilët dorëzojnë Aplikimin e plotësuar për Asistencë Financiare ("Aplikimi"), i cili përfshin dokumentet/informacionet e nevojshme, dhe që konsiderohen të kualifikueshëm për asistencë financiare nga "Northwell Health".

Si të aplikoni - FAP dhe Formulari i aplikimit mund të merret/plotësohet/dorëzohet si më poshtë:

- Pranë sportelit kryesor të çdo spitali të "Northwell Health" ose pranë sportelit të Departamentit të Urgjencës të "Northwell Health";
- Kërkoni që dokumentet t'ju vijë me postë, duke telefonuar Drejtorinë e Asistencës Financiare të "Northwell Health" në numrin e telefonit: 1.800.995.5727;
- Kërkoni dokumentet me postë/ose duke u paraqitur personalisht pranë spitalit përkatës, sipas listës së mëposhtme;
- Shkarkoni dokumentet nga faqja e internetit e "Northwell Health": www.northwell.edu/manage-your-care/financial-aid-programs;
- Dërgoni me postë aplikimet e plotësuara (së bashku me gjithë dokumentacionin/informacionin që kërkohet sipas udhëzimeve për aplikimin) pranë departamentit përkatës të asistencës financiare në spitalin që ofron shërbimet, sipas listës së mëposhtme.

Përcaktimi i Kualifikueshmërisë për Asistencë Financiare - Në përgjithësi, pacientët e kualifikuar mund të marrin asistencë financiare, duke përdorur shkallëzimin dinamik, kur të ardhurat e tyre familjare janë në nivelin ose nën nivelin 500% të Udhëzuesit Federal për Nivelin e Varfërisë (Federal Poverty Guidelines, FPG). Kualifikimi për asistencë financiare nënkupton që pacientëve të kualifikuar do t'ju mbulohen, plotësisht ose pjesërisht, shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe se ata nuk do të faturohen më tepër se vlerat që u faturohen normalisht (amount generally, billed, AGB) personave të siguruar (AGB sipas përkufizimit në seksionin 501(r) të IRC (Kodi i të Ardhurave të Brendshme) të Shërbimit të të Ardhurave të Brendshme (Internal Revenue Service - IRS). Nivelet e asistencës financiare, bazuar vetëm në të ardhurat familjare dhe FPG janë:

- Të ardhurat familjare nga 0 deri në 100% të FPG
Asistencë e Plotë Financiare; pacientit do t'i faturohet 0 \$, ose niveli nominal i pagesës sipas përkufizimit të Departamentit të Shëndetësisë të Shtetit të Nju-Jorkut.
- Të ardhurat familjare nga 101% deri në 500% të FPG
Asistencë e Pjesëshme Financiare; AGB është shuma maksimale që mund t'i faturohet pacientit.

Përveç FPG, mund të merren parasysh kritere të tjera të rëndësishme në përcaktimin e kualifikueshmërisë (shihni Politikën e Asistencës Financiare), të cilat mund të sjellin përjashtime nga sa më lartë. Departamentet e asistencës financiare të "Northwell Health" do të shqyrtojnë aplikimet e plotësuara të dorëzuara, dhe do të vendosin për kualifikueshmërinë për asistencë financiare sipas FAP.

Aplikuesit të cilët dorëzojnë aplikime të paplota do të njoftohen dhe do t'u jepet mundësia që të dërgojnë dokumentacionin/informacionin që mungon në mënyrë që të merret një vendim në lidhje me kualifikimin e tyre për asistencë financiare.

"Northwell Health" e përkthen FAP, Aplikimin për Asistencë Financiare dhe këtë Përmbledhje me Fjalë të Thjeshta të Politikës së saj të Asistencës Financiare, në gjuhë të tjera, kur gjuha e parë e banorëve të komunitetit ku shërben spitali "Northwell Health" përfaqëson më pak se 5 përqind ose 1.000 individë të popullsisë që merr ose ka marrë shërbime nga subjekti "Northwell Health". Versionet e përkthyer vihen në dispozicion sipas kërkesës; në adresat e mëposhtme; dhe në faqen e internetit të "Northwell Health".

Për ndihmë, asistencë ose pyetje, ju lutemi vizitoni: sportelin e ambienteve spitalore të "Northwell Health" ose sportelin e Departamentit të Urgjencës të "Northwell Health"; ose paraqituni personalisht në adresat e listuara më poshtë, nga e hëna në të premte nga ora 9.00 deri në 17.00. Mund të telefononi dhe një konsulent financiar në numrin e telefonit: 1-800-995-5727.

Drejtorja e Asistencës Financiare e "Northwell Health" ofron shërbime për qendrat e mëposhtme: *North Shore University Hospital, Long Island Jewish Medical Center, Cohen Children's Medical Center, The Zucker Hillside Hospital, Huntington Hospital, Lenox Hill Hospital, Manhattan Eye, Ear and Throat Hospital, Staten Island University Hospital, Franklin Hospital, Forest Hills Hospital, Glen Cove Hospital, Plainview Hospital, Southside Hospital and Syosset Hospital.*

Northwell Health
Financial Assistance Unit
35 Pinelawn Road
Melville, NY 11747-9001
Telefon: 1.800.995.5727

Adresa postare:
Northwell Health
Financial Assistance Unit
PO Box 9001
Melville, NY 11747-9001

Adresa e faqes së internetit: www.northshorelij.com/manage-your-care/financial-aid-programs/financial-assistance-program

Northern Westchester Hospital

Financial Assistance Unit
400 East Main Street
Mount Kisco, NY 10549-1096
Telefon: 914.666.1512

Adresa e faqes së internetit: www.nwhc.net/for-patients-and-visitors/financial-assistance

Phelps Memorial Hospital Center

Financial Counseling
701 North Broadway
Sleepy Hollow, NY 10591-1096
Telefon: 914.366.3133
Email - billing@pmhc.us

Adresa e faqes së internetit: www.phelpshospital.org/patient-visitor-info/billing/

Peconic Bay Medical Center

Financial Assistance Coordinator
1300 Roanoke Avenue
Riverhead, NY 11901
Telefon: 631.548.6099

Adresa e faqes së internetit: www.pbmchealth.org/medical-centers-and-services/peconic-bay-medical-center/billing/